



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E ADMINISTRIMIT TE BUXHETIT GJYQESOR
NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSEM

NR.PROT. 21

Tiranë, më 16 /05/2016

DREJTUAR : KRYETARIT TE GJYKATES
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANE

Lenda : Ju paraqesim raportin final te auditimit

I nderuar z. Selita

Bashkangjitur kësaj shkrese ju përcjellim raportin final të auditit, të kryer nga NjAB-ja ne institucionin tuaj.

Duke ju uruar pune te mbare,

Me respekt,

Luljeta LAZE
DREJTORE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR
NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM

Nr. REF. 02

Tiranë, më 11.05.2016

DREJTUAR : **KRYETARIT GJYKATES**
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANE

LENDA : **Ju paraqesim Raportin Final te Auditimit.**

I nderuar z. Selita !

Njësia e auditit të brendshëm në bazë të programit vjetor të auditit te miratuar në Bordin Drejtues per vitin 2016, realizoi misionin e auditit me objekt: “Zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë se veprimtarise ekonomiko-financiare te gjykates tuaj” për periudhën 01.11.2013 deri në 31.12.2015.

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 18, neni 11 pika pika c, në Manualin e Auditimit Publik, Manualin Specifik të Gjyqësorit u hartua Raporti Final i Auditit .

Duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit nga ana Juaj dhe të stafit të institucionit që ju drejtoni në kryerjen e auditimit, NJAB- arriti në konkluzionin që:

Gjykata Administrative e Apelit Tirane paraqet një performancë të miret në menaxhimin e fondeve buxhetore, prokurime publike, burimeve njerëzore si dhe shërbimeve gjyqësore.

Gjykata ka marrë disa masa për përmiresimin e shërbimeve gjyqësore ndaj publikut duke menaxhuar asetet publike për nje shërbim sa më të mirë e me standarte

Raportimet financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale të institucionit dhe i kanë dhënë menaxherit të lartë informacionin e duhur për menaxhimin e fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit si dhe shërbimeve gjyqësore.

Nga auditimi i ushtruar në institucionin që Ju drejtoni, u konstatuan disa mangësi , të cilat më hollësisht janë trajtuar te gjetjet nga auditimi .Lidhur me to janë lënë rekomandimet për zbatim nga ju në funksion të përmiresimit dhe arritjes se standartit të krijuar si dhe rritjes së cilësisë së funksionimit të institucionit.

Nga ana e gjykatës të vlerësohen rekomandimet e lëna dhe brenda 30 ditëve të hartohet plan – veprimi perfundimtar ,të përcaktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij dhe të dërgohet pranë NJAB.

Për zbatimin e plan veprimit duhet të informoni sipas afateve të përcaktuara

Bashkëngjitur keni Raportin Final të auditimit.

Duke Ju uruar punë të mbarë, shpresojmë në bashkëpunimin Tuaj.

Me respekt,

Artur MAMADHAJ

Drejtuesi i Njesisë së Auditimit



PASQYRA E LËNDËS

1.PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

2.HYRJJE

3.METODA E AUDITIMIT

4.GJETJET DHE KONKLuzionET

5.ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË

6.OBSERVACIONE

7.KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET.

I.Përmbledhje ekzekutive.

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, gërma “c” e tij, në “Manuali i Procedurave të Auditimit”, Manualit Specifik të Auditimit të Pushtetit Gjyqësor, VKM Nr. 806, datë 06.12.2006 “Metodika e Auditimit Financiar”, programit të auditimit të miratuar në Bord për vitin 2016 dhe në zbatim urdher shërbimit nr. 02 datë 02/03/2016 u realizua ky mision auditimi.

Qëllimi i misionit të auditimit është vlerësimi i veprimtarisë drejtuese dhe administruese të Gjykatës, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për funksionimin e këtij institucioni, lidhur me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, përdorimin e granteve publike , kryerja e shërbimeve si dhe administrimin e pasurisë publike.

Misioni auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga z.Aristotel Telhaj inspektor auditimi përgjegjës grupi, z.Agim Koçi inspektor auditimi dhe Trendafil Ajazi inspektor auditimi.

U konstatuan probleme që kanë të bëjnë me krijimin dhe funksionin e kontrollit të brendshëm, raportimin publik, pagave dhe pagesave e tjera .

Është kontaktuar dhe diskutuar me punonjësit e Gjykatës për problemet e konstatuara dhe në përfundim të tij, më datën 11.05.2016, u hartua Raporti Final.

Mbi bazën sistemeve të audituar janë dhënë rekomandimet në pikën VI projekt raportit për :

1. *Sistemin organizativ*
2. *Sistemin e hartimit dhe zbatimit buxhetit*
3. *Sistemin e pagave dhe pagesave*
4. *Sistemin prokurimit dhe blerjet e vogla dhe zbatim kontratash*
5. *Sistemin e raportimit publik*
6. *Sistemi IT*

II .Hyrje

Kushtet e punës në gjykatë nuk krijojnë mundësinë e funksionimit normal e në përputhje me standartet e pranuar të aktivitetit të gjykatës dhe shërbimeve gjyqësore.

Aktiviteti financohet nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga të ardhurat detyësore që realizohen nga tarifatat e shërbimit gjyqësor .

Ky institucion mban dhe ruan dokumenta me aktivitet të shërbimit gjyqësor administrativ, të aktivitetit ekonomik, të pasurisë publike dhe marrdhënieve të punës.

Auditimi përfshiu periudhën nga 01.11.2013 deri në 31.12.2015.

III. Metodatat e Auditimit

Në misionin e auditimit u është kushtuar rëndësi metodave dhe teknikave të manualit të auditimit. Janë përdorur metodat dhe teknikat e auditimit si: intervistat, llogaritjet matematikore, sondazhet, përzgjedhja, etj.

Grupi auditimit është njohur me të gjithë dokumentacionin që ka menduar se është i nevojshëm dhe i ka siguruar gjurma e auditimit në gjykatë.

U plotësuan dy pyetësor për vlerësimin e rrishtit për fushën e llogarisë dhe për mjedisin e kontrollit të brendshëm.

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Në përfundim të këtij procesi rezulton se në fushën e llogarisë dhe në krijimin dhe funksionimin e mjedisit të kontrollit, gjykata vlerësohet me *rrisk të larte*.

IV.Gjetjet dhe konkluzionet

4/1.Funksionimi organizativ i Gjykatës.

Gjykata Administrative e Apelit Tirane, funksionon në bazë të ligjit nr.9877, date 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar me ligjin nr.100/2014 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”.

Punonjësit administrativë të gjykatës, veprojnë dhe realizojnë detyrat e tyre, ne mungese te nje Rregulloreje te Brendshme te unifikuar per te gjitha gjykatat administrative, kompetence e Ministrise te Drejtesise. Keshtu ne keto kushte kur nuk eshte hartuar nje dokument i tille , ne nevojte te gjykates, **nuk eshte miratuar Rregullorja e Brendshme** ku te gjejne pasqyrim pergjegjesite e cdo hallke te menaxhimit dhe administrimit publik, sipas detyrimeve qe rrjedhin nga Ligji nr.10296/2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Kjo dhe ne zbatim te Ligjit Nr. 9877 datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18 “Kompetencat e Kryetarit të Gjykatës”, pika g) “...Kryejne detyra te tjera ne funksjon te drejtimit administartiv te gjykates, te parashikuara ne aktet ligjore ose nenligjore.....”. Nga ballafaqimi ne lidhje me kete problem dhe infomacionit te grumbulluar gjate auditimit rezulton se hartimi i Rregullores te Brendshme eshte ne proces dhe se shpejti do te miratohet nga Kryetari i Gjykates.

Nga auditimi konstatohet se ne mungese te Rregullores ndarja e detyrave, pershkrimet e punes dhe pergjegjesite nuk jane te qarta dhe sipas struktures aktuale per cdo punonjes qe ka funksione për menaxhimin e fondeve buxhetore, mbrojtjen e asetëve publike nga abuzimet, përdorimin e tyre me efektivitet, efçence e ekonomi, duke perfshire detyrimet qe rrjedhin nga ligji nr.10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Auditi rekomandon:

Te miratohet Rregullorja e Brendeshme, ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndyshuar, ku ndarja e detyrave, pershkrimet e punes dhe pergjegjesite te jene te qarta dhe sipas struktures aktuale per cdo punonjes qe ka funksione për menaxhimin e fondeve buxhetore, mbrojtjen e asetëve publike nga abuzimet, përdorimin e tyre me efektivitet, efçence dhe ekonomi.

Në mbështetje të legjislacionit përkatës, Gjykata kryen veprimtarine e saj proceduriale dhe administrative, ku përfshihen: Pranimi, mbajtja dhe administrimi i akteve proceduriale, provave shkresore të paraqitura, organizimi i shortit për ndarjen e çështjeve, si dhe shpërndarja e çështjeve për gjykim sipas shortit, njoftimet dhe komunikimet e akteve proceduriale, përgatitja dhe shpallja e listës së gjykimeve, mbajtja e procesverbaleve të seancës gjyqësore, si dhe respektimi i kërkesave të solemnitetit në gjykim, etj.

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit nr.9887, date 10.03.2008, i ndryshuar mbi “Mbrojtjen e te dhenave personale”, Udhezimit Nr.15, date 23.12.2011 per “Perpunimin dhe publikimin e te dhenave personale ne sistemin gjyqesor”, Vendimit nr.1, date 04.03.2010 per “Percaktimin e rregullave te hollleshme per sigurimin e te dhenave personale”, si dhe akteve te tjera te Agjensise Kombetare te Shoqerise se Informacionit, Gjykata nuk ka hartuar dhe miratuar akoma nje Rregullore specifike per IT qe te

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

garantoje sigurine e sistemit te IT (per ndryshimin e fjalekalimeve rregullisht, regjistrimin apo heqjen e perdoruesve, hyrjet e kufizuara ne te dhenat..... etj).

Auditi rekomandon:

Ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr.9887, date 10.03.2008, te ndryshuar mbi "Mbrojtjen e te dhenave personale", Udhezimin Nr.15, date 23.12.2011 per "Perpunimin dhe publikimin e te dhenave personale ne sistemin gjyqesor", Vendimin Nr. 1, date 04.03.2010 per "Percaktimin e rregullave te hollesishme per sigurimin e te dhenave personale", si dhe akteve te tjera te Agjensise Kombetare te Shoqerise se Informacionit, te hartohet e miratohet Rregullorja specifike per IT.

Procedurat e shortimit elektronik.

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tirane, është në funksionim sistemi i integruar i menaxhimit të çështjeve administrative (ICMIS), nëpërmjet të cilit ndarja rastësore e çështjeve për gjykim. Ndarja e çështjeve në gjykatë është bërë mbi bazën e shortit elektronik, mbas depozitimit dhe regjistrimit të çështjeve. Kjo procedurë aplikohet në përputhje me vendimin Nr.238, datë 24.12.2008 të K.L.D "Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore", me qëllim hedhjen në short të kërkesave brënda një afati 7 ditor.

Dosja personale e gjyqtarit.

Për efekt të vlerësimit përshkrues që kryen Titullari në kuadër të sistemit të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, në mënyrë që ky vlerësim të jete sa më i bazuar, objektiv dhe i besueshëm, si dhe per efektete financiare korrekte - *per vjetersite e pagueshme*, krahas fashikullimit që ekziston në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk eshte krijuar një fashikull i ngjashëm edhe në Gjykatën Administrative të Apelit Tirane.

Auditi rekomandon:

Pagesa e vjetersise ne sherbim te Gjyqtareve te llogaritet mbi bazen e te dhenave zyrtare te KLD-se. Per keto vjetersi Dega e Buxhetit duhet te disponoje nje dokument nga KLD, e cila mban regjistrin kombetare te gjyqtareve. Akti administrativ te dale nga Titullari Institucionit pasi te merren ne rruge zyrtare nga KLD te dhenat per vjetersine e pagueshme per cdo Gjyqtare.

Struktura, organika e Gjykates.

Per periudhen e audituar eshte miratuar struktura organizative nga Ministri i Drejtesise pa marre mendim si nga Kryetari i Gjykates ashtu dhe nga Bordi Drejtues i ZABGJ, respektivisht me Urdherat; nr. 563, date 25.10.2013 me 14 punonjes, nr. 153 date 04.03.2014 me 22 punonjes dhe nr.1477/5, date 03.06.2015, me 35 punonjes.

Struktura organizative e Gjykates eshte miratuar nga Ministri i Drejtesise, pa marre nje mendim ose propozim nga Kryetari i Gjykates apo ZABGJ, si organe pergjegjes per mirefunksionimin e ketij institucioni. Kjo situatë gjykohet se ka shkaktuar dhe ngarkesen e larte te ceshtjeve per cdo gjyqtare dhe pamundesi te perballimit me staf administrative te problematikave te perditeshme te administrimit gjyqesor.

Auditi rekomandon:

Nga ana e gjykates te hartohet dhe te dergohet prane KLD-se, Ministrise se Drejtesise dhe ZABGJ-re, nje raport mbi nevojat per burime njerezore te argumentuar ne baze te ngarkeses individuale, bazuar ne nje detajim te plote te detyrave te gjithesecilit duke evidentuar problemet qe hasen gjate administrimit te punes ne Institucion. Ky raport gjykojme se do te sherbeje si nje nxitje pozitive per te adresuar problematikat e evidentuara te mungeses te kapaciteteve njerzore ne perballimin e funksioneve kryesore te gjykates.

b.Praktika e menaxhimit të burimeve njerëzore. Zbatimi i akteve ligjore e nënligjore në lidhje me rekrutimet e reja, largimet, vlerësimet dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Mbi procedurat e rekrutimit.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekzistojnë procedura të qarta të shpalljes së vendeve vakante, të konkurimit, si dhe të përzgjedhjes së punonjësve administrativ. Për plotësimin e çdo vendi vakant, nuk është ngritur një *komision ad hoc*, që ka për detyrë që të hartojë kriteret konkrete të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, të realizojë publikimin, mbledhjen e dokumentacionit, konkurimin nëpërmjet intervistimit, dokumentimin dhe arshivimin e të gjithë procedurës. Kryetari i gjykatës mbas mbarimit të kesaj procedure të lidhe me punëmarrësin, fillimisht një kontratë me afat në kohë prove deri në tre muaj.

Auditi rekomandon:

Për plotësimin e çdo vendi vakant, të ngrihet një komision ad-hoc, që të hartojë kriteret konkrete të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, të realizojë publikimin, mbledhjen e dokumentacionit, konkurimin nëpërmjet intervistimit, dokumentimin dhe arshivimin e të gjithë procedurës. Kryetari i gjykatës mbas mbarimit të kesaj procedure të lidhe me punëmarrësin, fillimisht një kontratë me afat në kohë prove deri në tre muaj.

Regjistri Themeltar i punonjesve.

Nga auditimi, rezulton se është çelur regjistri themeltar i punonjesve sipas nenit 96 “Regjistri”, të ligjit nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, regjistër i cili nuk është përditësuar në të gjitha rastet e lëvizjes së punonjësve të administrates së gjykatës.

Regjistri themeltar i punonjesve, nuk është vulosur dhe numëruar në çdo fletë, si e metë evidentohet mos plotësimi në të gjitha referencat e tij (azhurnuar deri në datën 16.06.2014, nga nr.1 deri në 23).

Nga auditimi i dosjeve të punonjesve administrativ konstatohen raste të mungesës të dokumentave që duhet të përmbajë dosja personale e çdo punonjesi, të parashikuara në VKM-ne Nr.117 date 05.03.2014 “Per Permbajtjen, Procedurën dhe administrimin e Dosjeve të personelit ...”.

Kryetari Gjykatës (në cilësinë e punedhësit) nuk ka lidhur kontratë pune me punonjesit administrativ të gjykatës (në cilësinë e punëmarresit).

Auditi rekomandon:

Dosjet e punonjesve të krijohen dhe të plotësohen sipas standartit të kerkuar për regjistrin kombëtar të punonjesve publik, bazuar në VKM-ne Nr. 117 date 05.03.2014 “Per Permbajtjen, Procedurën dhe administrimin e Dosjeve të personelit.....”. Dosjet e punonjesve dhe Regjistri themeltar i punonjesve të mbahen dhe azhurnohen nga Kancelari sipas kërkesave ligjore të marrëdhënieve të punës. Per gjyqtaret krahas dosjes që kanë në KLD, të krijohet dosja e ngjashme edhe në Gjykatë, në kuadër të vlerësimit profesional si dhe për efektet financiare korrekte për vjetërsitë e pagueshme.

c. Menaxhimi i rriskut, dhe masat për parandalimin e ngjarjeve që rrezikojnë objektivat (me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet). Regjistrimi dhe raportimi i masave për parandalimin e parregullive, abuzimeve dhe mashtrimeve.

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Ne mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (MFK), i ndryshuar, u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Njësia shpenzuese, në bazë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 te ndryshura, ka hartuar pyetësin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2014 dhe 2015 dhe me shkresat nr.44 prot. date 05.02.2015 dhe nr.15 prot. date 15.01.2016 i ka derguar në ZABGJ. Nuk është hartuar deklarata për cilesin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2014 në kundërshtim me nenin 18 të ligjit Nr. 10296 date 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

a) Mjedisi i kontrollit.

Struktura organizative - Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, sipas evidencave statistikore dhe raporteve vjetore të analizës së aktivitetit nga ky institucion, konstatohet se aktiviteti i gjykatës rritet nga viti në vit.

Struktura e gjykatës, nuk është tërësisht e përshtatur për kryerjen e detyrave të saj, duke paraqitur ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi. Përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë e personelit të gjykatës, sic e trajtuam edhe me lartë nuk janë të specifikuar në një rregullore të shkruar. Konstatohet se struktura aktuale nuk përballon të gjitha funksionet e Gjykatës.

Ne përputhje me Kreun II, neni 8, pika 8(b) të Ligjit Nr.10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar, me Urdherin nr.58 prot. date 29.02.2016 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik(G.M.S) i njesise ne perberje te te cilit eshte Kryetari i Gjykatës, ne cilesine e Nën-punësit Autorizues, Kancelari, ne cilesine e Menaxherit dhe Kryetarja e Degës të Buxhetit ne cilesine e Nën-punësit Zbatues

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore

. Në mungesë të Rregullore së Brendshme, përshkrimet e punës të administratës së gjykatës, nuk janë të specifikuar, nuk janë të përcaktuara kriteret lidhur me strukturat menaxheriale, kualifikimet e nevojshme të personelit, etj.

Nga auditimi konstatohet se nuk ekziston një planifikim mbi baza vjetore për trajnimet që zhvillohen në gjykatë. Nga ana e Gjykatës nuk janë zhvilluar trajnime me personelin në lidhje me njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, prokurimet publike, menaxhimin e burimeve njerëzore etj. Me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit. Në gjykatë zhvillohen trajnime jo të dokumentuara, të lidhur me përditësimin e administratës me legjislacionin në fuqi etj.

b) Menaxhimi i riskut.

Në lidhje me menaxhimin e rriskut, është hartuar regjistri i rriskut në përputhje me kërkesat e nenit 11, pika 2 dhe nenit 12, pika 3(d) të ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar, i cili është derguar në ZABGJ bashkë me pyetësin e vetëvlerësimit dhe zbatimit të plan veprimit, në mënyrë elektronike dhe shkresore. Nuk ka asnjë nënshkrim apo miratim, në të cilat janë përcaktuar mbrojtja e aktiveve nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, risqet që ato paraqesin, mekanizmat e kontrollit të tyre, personat përgjegjës për kontrollin, periudhën kur kryhet kontrolli dhe personi tek i cili bëhet raportimi mbi këto aktivitete.

Identifikimi dhe çështje që kanë të bëjnë me risqet në arritjen e objektivave, trajtohen në mbledhjet javore të menaxherëve të institucionit, por nuk dokumentohen. Rezultatet dhe konkluzionet e mbledhjeve, i komunikohen stafit për të ndërgjegjësuar praninë e risqeve

Në përputhje me nenin 10 të ligjit MFK, konstatohet se nuk ka funksionuar koordinatori i rriskut..

c. Aktivitetet e kontrollit.

Një kontroll i rëndësishëm mbi aktivitetin e gjykatës, është ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësiive të personelit, ne mungese te Rregullores te Brendëshme, kjo ndarje mungon, struktura mbi të cilën funksionon institucioni lë pak vënd për mospërfshirjen e një punonjësi në më shumë se një detyrë njëkohësisht.

Nuk ju eshte dhene rendesi kontrolleve parandaluese dhe zbuluese, që kryesisht kane të bëjnë me sigurinë, për shkak të funksionit dhe kushteve që ka Institucioni.

Kështu :

- hyrja e gjyqtareve dhe personelit administrativ të gjykatës dhe paleve ne gjykim është e njejte me publikun;

- mos egzistenca e paisjes Metal Dedektor ne hyrje te gjykates;

- mungesa e monitoreve(kamerave) ne ambjentet e sherbimit;

- mungesa e ambjenteve te nevojshme te punes per te pasur nje infrastrukture te domosdoshme per vijushmerine normale te punes;

- mos pasja e ambjenteve te mjaftueshme per arkivimin, perpunimin e dokumenatave dhe funksionimin normal te arkives dhe kryrja ne kohe te sherbimeve gjyqesore ndaj qytetareve.

Nga ballafaqimi dhe informacioni i grumbulluar gjate auditimit ne lidhje me problemet e trajtuara me larte, rezulton se gjykata se shpejti do te transferohet ne ambjentet e ish Ministrise te Mjedisit.

d. Informacioni dhe komunikimi.

Për sa i përket komunikimit në nivelin horizontal dhe vertikal, brënda për brënda institucionit, nuk ekziston nje rregullore për komunikimin me shkrim, elektronik, ose verbal, por dalin urdhera, të cilat komunikohen me anë të shpalljeve ose kalimit fizik.

Ne këtë institucion kontrole ushtrohen në drejtim të ruajtjes së të dhënave të hyra në servere-t e sistemeve, e konkretisht kryhet back-up i të dhënave të sistemit qëndror të gjykatës, të sistemit (sistemi elektronik i çështjeve gjyqësore), në të cilën regjistrohen të gjitha çështjet gjyqësore dhe ecuria e tyre. Back-up është ditor si lokalisht ashtu edhe nëpërmjet rrjetit të krijuar nga AKSHI dhe Ministria e Drejtësisë. Testimi i këtij procesi është automatik, dhe kryhet nga vetë sistemi duke u mirembajtur nga specialistja e TI.

Në këtë institucion, evidentohen përpjekje për të ruajtur sigurinë e të dhënave individuale në çdo kompjuter, por përgjithësisht është lënë në dorë të individeve për të vendosur fjalekalim, si mjet për parandalimin e hyrjeve të paautorizuara. Gjithashtu, nje kontroll i aplikacionit, është edhe mos ndryshimi i informacionit të regjistruar në sistemin ICMIS mbi të dhënat gjyqësore, pa marrë miratim nga strukturat e menaxhimit.

Gjykata Administrative e Apelit Tirane disponon faqen zyrtare te internetit(website) për komunikimin e çështjeve gjyqësore, per afishimin direkt nga sistemi i çështjeve qe regjistrohen. Gje e cila mundeson qe publiku, punonjësit dhe gjykatësit te informohen në kohë mbi oraret dhe specifikat e seancave gjyqësore.

Ne hyrje te gjykates eshte vendosur kendi i njoftimeve, mungon kutia per kerkesat dhe ankesat e qytetareve.

e. Monitorimi.

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tirane, është kryer procesi i monitorimit nepermjet raportimit te menaxhereve tek Kryetari i Gjykates, nepermjet raportimeve periodike dhe analizave te kryera per

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

fusha te vecanta te veprimtarise se sektoreve te gjykates. Si institucion i ri per here te pare auditohet(monitrohet) nga NJAB.

4.2.Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.

Ne zbatim të Ligjit Nr. 9936 dt.26.06.2008 “ Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë“ , udhëzimeve përkatëse të M.F.nr 7 date 28.02.2014 ‘ ‘ Per pregatitjen e programit buxhetor afatmesem 2015-2017 ’ ’ date 28.02.2014 si dhe vendimeve të Bordit e shkresave të ZABGJ-s, është bërë hartimi, detajimi dhe miratimi i projekt buxhetit për vitin 2015 dhe PBA-n 2015-2017 dhe është dërguar ne ZABG Planifikimi i fondeve për mallra e shërbime, është bërë në bazë të standarteve orjentuese per disa kategori shpenzimesh , per disa kategori shpenzimesh është marrë ne konsiderate performanca 3 mujorit te pare 2014. Ne relacionin e dërguar janë dhënë shpjegime per cdo kerkese buxhetore si shpenzime per paga, per shpenzimet operative ,materiale e shpenzime zyre , shërbime , shpenzime e mirembajtje te zakonshme, shpenzime te tjera speciale , paisjet elektronike. Janë parashikuar te ardhurat per vitet 2015 -2017.

Me shkresën nr.104 prot. Date 31.03.2015 është dërguar nga ZABGJ shkresa Per hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesem 2016-2018 .

Gjatë auditimit, në drejtim të planifikimit të buxhetit për vitet pasardhëse dhe detajimit të buxhetit të miratuar për vitin ushtrimor, u konstatua se janë përdorur të dhëna nga statistikat, rregullat e thjeshta matematikore, tendencat e çmimeve, rinovimi i teknologjisë, vlerësimi i të dhënave statistikore të viteve të mëparshme, normativave (qoftë edhe orjentuese) përkatëse të materialeve për konsum, numrin e punonjësve dhe shpenzimet për trajnimin e gjyqtareve e punonjësve.

Gjykata është përpjekur të parashikojë e të kërkojë fonde për funksionimin normal e sipas standarteve të gjykatës, por duke i qëndruar korrekt standarteve orientuese e tavaneve buxhetore të miratuara nga Min.Fin. me udhëzimet përkatëse për hartimin e p/ buxheteve (PBA) përkatëse.

Gjate auditimit te hartimit te projekt -buxhetit u konstatuan keto mangesi :

- a). Nuk ka një program masash për hartimin e buxhetit ku të përcaktohen afatet edhe personat që do marrin pjesë në këtë proces, duke ja lënë gjithë procesin vetëm një personi, K/Degës Buxhetit.
- b)Nuk është ngitur grupi i punës për të paraprirë për hartimin e PBA për vitin 2016-2018 . Per sa me siper mban pergjegjesi nepunesi zbatues dhe menazherve te tjere sipas kerkesave te ligjit 10296 date 08.07.2010 ”Per menazhimin Financiar dhe kontrollin.”neni 12. dhe 31.
- c). Mungon relacioni ku të argumentohen sakte kërkesat buxhetore ,per cdo ze shpenzimesh. Gjithashtu projekt buxheti duhet të shoqerohet me dokumentin baze Deklarata e Politikës së Programit ,ku përcaktohen qarte objektivat ne funksion te mbeshtetjes buxhetore .

2. Zbatimi I Buxhetit

Programi dhe zbatimi i buxhetit është kryer ne zbatim te Ligjit.Nr. 119/2012 datë 17.12.2012” Për buxhetin e vitit 2013”, udhëzimit Ministrisë së Financave. Nr. 1/1 datë 19.02.2013 ”Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2013”, Ligjin.Nr. 185/2013 “Për Buxhetin e vitit 2014”, udhëzimin e Ministrisë Financave nr. Nr. 3, datë 17 /01 /2014 ”Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2014” udhëzimit nr.3 date 16.01.2015. Per shitesa e ndryshime te udhezimit nr.2 date 06.02.2012 Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit.” dhe sipas programit buxhetor të miratuar e dërguar nga ZABGJ-ja.

Nga dega e buxhetit nuk janë hartuar situacione mujore , te cilat duhet te jene rakorduar e nenshkruar nga Dega e Thesarit si per shpenzimet qe jane planifikuar te perballohen nga buxheti shtetit , edhe per shpenzimet e kryera nga perdorimi i te ardhurave dytesore te cilat duhet te jene perdorur ne cdo rast sipas miratimeve , apo rritjes se autorizimeve buxhetore .

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Ne raportet e monitorimeve rezultojne treguesit e realizimeve te buxhetit sipas artikujve. Por ne raportimin e kryer nuk eshte bere nje analize e interpretim konkret sipas struktures buxhetore. Realizimi i buxhetit per vitin 2014 eshte ne masen 93% ndersa per vitin 2015 ne masen 99% cka tregon nje performance te mire ne realizimin e fondeve te planifikuara.

4.3. Zbatimi i procedurave ligjore dhe nen ligjore per pagat, shtesat mbi pagat dhe sherbimet e personelit.

Sistemi i pagave në Gjykatë, bazohet në Ligjin Nr. 9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 114/2013 date 11.04.2013, ligjin 100/214 date 31.07.2014 dhe vendimet përkatëse të KM për pagat e administratës gjyqësore.

U përzgjedhen për auditim për vitin 2013 listë pagesat e muajit dhjetor, për vitin 2014 listpagesat per muajt, Prill, Qershor, Gusht, Dhjetor dhe per vitin 2015 listpagesat e muajve Shkurt, Korrik, shtator, Nentor .

Nga auditimi i listpagesave u konstatua :

1. Nga krahasimi i numrit te punonjesve sipas struktures se miratuar me numrin e punonjesve ne fakt rezulton i barabarte.
2. Hartimi i listë pagesave eshte kryer sipas të gjitha rubrikave te kerkuara për shtesat e ndalesat. Po kështu janë bërë të gjitha pagesat për tatimet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe sigurimin suplementare.
3. Nga kryerja e testimeve për saktësinë e llogaritjeve të pages, përputhjes së pages me pozicionin e punes sipas përcaktimeve të bëra në VKM-t përkatëse, llogaritjen e shtesave për vjeteresi, përputhjen dhe saktësinë e pagave të paguara ne bankë sipas punonjësve me pagen neto ne listepagesë rezulton se jane llogaritur sakte.
4. Vjetërsia e punes në sherbim, për gjyqtarët llogaritet mbi baze te librezave te punes dhe te shkresave te emerimeve nga Ministria e Drejtesise ose dhe te dekreteve respektive .
5. Vjetërsia e punes per administratën gjyqësore kryhet mbi bazen e librezave te punes dhe llogaritet nga K/D/Buxhetit e cila njëherësh llogaritet dhe pagën, jo nga punonjesi i ngarkuar per Personelin, ne perputhje me ligjin nr.10296 dt.08/07/2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 20 pika 2/c, neni 22 pika 3, neni pika b dhe c. Cka bie ne kundreshtim me referencat e siperpermendura ligjore .
6. Liste prezenca për paraqitjen në pune mbahen dhe mbi bazën e tyre hartohet listë pagesa mujore. Liste prezencat jane mbajtur sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30 date 27/02/2011 “Menaxhimi i Aktiveve ne NJSP” kreu III paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlere”, pika 69 dhe 71, Udhëzimit të Bordit Nr. 3 datë 07.05.2012 “Për Proçedurat e Ruajtjes, Mbrojtjes dhe Kriteret e Kompetencat për Nxjerrjen nga Përdorimi të Aktiveve në Njësitë e Gjyqësorit”, kap. V, paragrafi i fundit dhe Udhëzimit Nr. 2.datë 06.02.2012 të Ministrisë Finanacave (listë pagesa llogaritet e plotesohet mbi bazën e liste prezencës për paraqitjen ne pune të plotesuar sipas formatit të përcaktuar në këto udhëzime).

Gjate ushtrimit te auditimit u kryen teste per perputhjen e diteve te punes te shenuara ne liste prezence me ditet e punes ne liste pagese dhe rezulton se llogaritja e tyre eshte kryer me saktesi.

Auditimi për të ardhurat nga tarifat për shërbime gjyqësore.

Nga auditimi u kostatua se janë aplikuar drejt tarifat gjyqësore ne perputhje me udhezimin nr.13 date 12.02.2009 "Per percaktimin e tarifes se sherbimit per veprime e sherbime te administrates gjyqësore e M.Drejtësisë ,sherbimit permbarimor shtetëror,prokurorise,noterise dhe ZRPP " *te ndryshuar shtojca 1* si dhe **udhezimit Nr 991/3 date 02.03.2010** Per nje ndryshim ne udhezimin nr.13 date 12.02.2009 " Per percaktimin e tarifes se sherbimit ...administrates gjyqësore " si dhe janë arketuar ato.

Per gjithë periudhen e audituar rezulton se të ardhurat janë të rakorduara me degen e thesarit ne fund te vitit

Nga dega e buxhetit nuk ka regjistrime te detajuara per te ardhurat e realizuara nga sherbimet gjyqësore.

4.4.Sistemi i transaksioneve për blerjet, shpenzimet dhe rregjistrimi i tyre në rregjistrat e kontabilitetit

U auditua i plote dokumentacioni i bankës (thesarit) për vitin 2013(nga 01/11-31/12), gjithsej 25 U.SH. ose 100 % e tyre, për vitin 2014 me zgjedhje, 90 U.SH. nga 134 U.SH. gjithsej ose 67 % e tyre dhe për vitin 2015 me zgjedhje 50 U.SH. nga 129 U.SH. gjithsej ose 40 % e tyre.

Në përfundim të auditimit rezulton se regjistrimet në "Ditarin e Bankes" janë bërë korrekt si për vlerat ashtu edhe për kronologjinë e regjistrimit të ngjarjeve ekonomike .

Vlera totale e situacioneve per vitin 2014 ne shumen 35.142.215 lek dhe per vitin 2015 ne shumen 48 739 712 lek perputhen me vlerat totale ne ditarin e bankes te viteve perkatese.

Rakorimet me degen e Thesarit per fondet e perdorura janë kryer periodikisht dhe ne fund te vitit, jane të konfirmuara nga dega e Thesarit dhe janë pjesë shoqëruese e dokumentacionit të bankës.

Pagat e punonjësve janë kaluar në llogaritë personale në bankë dhe nga ana e tyre nuk ka reklamime.

Njëkohësisht u bë krahasimi i cmimeve në kontratat e lidhura, në blerjet me vlera të vogla me faturat e lëshuara nga operatorët ekonomikë si dhe fletshyrjeve të magazinës dhe rezulton se janë të barabarta.

U auditua dokumentacioni shoqërues i Urdhër Shpenzimeve , si faturat , kontratat , flet hyrjet e magazinës , përmbledhëset e listpagesave dhe listpagesat,etj dhe rezulton se vlerat e tyre përputhen me vlerat në urdhër shpenzim.

Dokumentacioni shoqërues i cdo transaksioni është i konfirmuar me vulën e thesarit.

Shpenzimet per përkthyes.

Gjatë ushtrimit të misionit të auditimit ne drejtim të perputhshmerise ligjore te kryerjes se shpenzimeve konstatohet se për periudhen nen auditim nga gjykate eshte kryer nje pagese per perkthyes ne vleren 11 000 lek .Per kete pagese eshte mbajtur tatimi ne burim ne masen 10% ne vleren 1100 lek dhe eshte derdhur ne DRT Tirane. Pagesa e kryer per perkthyesen znj.Manjola Sopotit me U.SH. nr.91 date 02/10/2014 ne shumen neto 9900 lek(*total 11000 lek - tatim ne burim 1100 lek =9900lek*) eshte ne kundërshtim me Ligjin 49/2012 "Per organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative" i ndryshuar neni 14: *Te drejtat dhe detyrat e paleve. Palët, përfaqësimi, të drejtat dhe detyrat e palëve dhe të përfaqësuesve, përgjegjësia e palëve për shpenzimet dhe për dëmet gjatë procesit, pjesëmarrësit e tjerë në gjykim rregullohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji*, me Ligjin 8116 date 29/03/1996 "Kodi i Procedures Civile" i ndryshuar Kreu IV: Përgjegjësia e paleve per shpenzimet gjate procesit dhe per demet gjate procesit. neni 105: *Parapagimi i shpenzimeve gjyqësore, Shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend parapaguhet nga pala që i ka kërkuar në shumën që ka caktuar gjykata. Por gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen*

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

pasurore të palëve, mund të ngarkojë njërën ose të dyja palët që të paguajnë shpenzimet e tyre, pavarësisht se kush prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit ose të këqyrjes.

Kur një palë është e detyruar që të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme, nenet 105/a dhe 106 dhe duhet të arketohet në buxhetin e shtetit.

Auditi rekomandon:

1. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, të nxirret akti administrativ, të kryhet kontabilizimi dhe të bëhet ndalesa për pagese e kryer në menyre të padrejta për perkthyesen në vlerën 9 900 lek.

Shpenzimet për energji elektrike, ujë, telefon, shërbim postar etj

Nga auditimi i shpenzimeve për energji elektrike, konstatohet se janë kryer mbi bazën e faturave mujore të lëshuara nga ana e operatorit të energjisë elektrike dhe vlera e faturuar kryhet nëpërmjet matësit të instaluar dhe kontratës të lidhur .

Shpenzimet për konsumin e ujit perballohen nga Gjykata e Apelit Civil dhe nuk ka kontrate me ujsjellesin.

Per shpenzimet postare faturat mujore të postës shoqërohet me kopje të regjistrimit postar .

Nga auditimi i shpenzimeve për telefon celular rezultoi se është respektuar limiti përcaktuar me VKM nr 864 datë 23/07/2010 pika 14 dhe 15 i ndryshuar.

Auditimi i veprimeve të Arkës dhe i letrave me vlerë .

Mjetet monetare dhe vlerat tjera pranë arkës (pullat e taksës) ruhen në kasafortën që ndodhet pranë arkës .

Nga auditimi konstatohet se nga ana e degës buxhetit nuk është mbajtur ditari i arkës. Nga ana e arkëtares nuk është mbajtur libri i arkës por vetëm libri i pullave të taksës.

Në librin e pullave janë pasqyruar tërheqjet e pullave nga dega e tatimeve dhe derdhjet në banke nga shitja e pullave.

Derdhjet në bankë janë kryer në periudha dy dhe tre javore dhe në vlera të larta ç’ka tregon për mbajtje në arke të vlerave monetare në shuma të larta.

Mosmbajtja e ditarit të arkës , librit të arkës dhe mbajtja e vlerave monetare në shuma të larta në arkë bie në kundërshtim me udhëzimin nr 30 datë 27/02/2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP” pika 62, 64, 67, 23.c, ku është përcaktuar se :

Pika 62. Veprimi arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njesive publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës.

Pika 64. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e parashkrimit për udhetime e dieta, gjithashtu edhe për arketimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 leke.

Pika 67. Për veprimet e arkës mbahen llogaritë kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare.

Pika 23.c Depozitimi në llogaritë e sistemit të thesarit i vlerave monetare të arkëtuara nga të gjitha nivelet e njesive të qeverisjes së përgjithshme, menjëherë pas pranimit të tyre.

Nga grupi i auditimit u krye inventarizimi fizik i arkës duke u bazuar në akt rakordimin e mbajtur midis gjykatës dhe degës së tatimeve për gjendjen e pullave të taksës më 31/12/2015 sipas akt konstatimit nr.01 datë 17/03/2016 .Nga kryerja e inventarit nuk rezultoi diferenca në mjete monetare dhe letra me vlerë .

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Auditi rekomandon :Nga dega e buxhetit te merren masa për mbajtjen e ditarit te arkës dhe librit te arkës, kryerjen e regjistrimeve kontabile për veprimet me arken , inventarizimin e vlerave monetare dhe te letrave me vlere cdo muaj, si dhe depozitimin ne llogarite e thesarit te vlerave monetare të arkëtuara menjehere pas pranimit te tyre.

Auditimi i veprimeve të magazinës

U audituan me zgjedhje dokumentacioni i magazines perkatesisht :

Për vitin 2013 (01/11 deri 31/12/2013), Flet Hyrjet e magazines 26 cop gjithsej ose 100% e totalit dhe Fletë Daljet gjithsej 1 ose 100% e totalit, për vitin 2014 F. Hyrjet e magazines, 17 nga 35 gjithsej ose 50% e totalit dhe F.Daljet e magazinës, 22 nga 49 gjithsej ose 48 % e totalit dhe për vitin 2015,u auditua, i plote dokumentacioni gjithsej 13 Flet Hyrje ose 100% dhe 49 Flet Dalje ose 100% e totalit.

Nga auditimi rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të materialeve në magazinë është plotësuar , në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga dega e buxhetit, nuk jane kryer regjistrimet në ditarin e magazines per vitin 2014 duke u mjaftuar vetem me mbajtjen e librit te magazines ndersa per vitin 2015 regjistrimet jane kryer ne programin Alpha. F.Hyrjet dhe F.Daljet janë prerë mbi bazën e dokumenteve justifikues ,fatura blerje me ose pa tvsh për hyrjet e magazinës dhe urdhër dorëzimit ose plan shpërndarjes të autorizuar nga kancelarja, për daljet e magazinës një kopje e të cilave sëbashku me dokumentacionin shoqërues është dërguar në degën e buxhetit për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. F.Hyrjet dhe F.Daljet janë të firmosura nga magazinjeri dhe financieri.

Nga ana e magazinës është mbajtur libri i magazinës ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet dhe gjendjet e artikujve Ndërmjet kartelave të magazinës dhe llogarisë nuk është kryer rakordimi periodik pasi nuk është mbajtur ditari magazinesj. Pajisjet dhe materialet e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale të nënshkruara prej tyre.

Gjykata Administrative e Apelit Tirane ka në inventarin e saj nje automjet, tip” mercedes benz “ me targa AA 542 JU e përdorur më parë, ardhur me transferim ne vitin 2015 e cila eshte ne gjendje pune.

Nga auditimi i ushtruar për shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve rezulton se ato janë kryer me procedure prokurimi “Blerje me vlerë të vogël”.

Për konsumin e karburantit janë mbajtur fletë e udhëtimet mujore por nuk jane firmosur nga shoferi për destinacionin e nisjes e të mbriritjes dhe punonjësi të cilit i është vënë autovetura në dispozicion.

Per autoveturen nuk eshte percaktuar normativa e konsumit te karburantit per 100/km dhe nga llogaritjet nga fletet e udhëtimet rezulton nje normative e larte konsumi prej 20 litra /100 km . Karburanti qe perdor kjo autoveture eshte benzine.

Gjykata ka gjenerator por per periudhen nen auditim nuk eshte përdorur.

Auditi rekomandon:

1. Nga ana e kryetarit te meren masa per percaktimin e normatives se konsumit te karburantit per autoveturen nepermjet ngritjes me urdher te brendshem te komisjonit per percaktimin e normativaves me matje faktike.

Inventarizimi i pasurisë publike

Eshtë kryer inventari fizik i Aktiveve Afatshkurtëra dhe Aktiveve Afatgjata të trupëzuara, në magazinë dhe në përdorim nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të kryetarit të gjykatës nr 912 date 24/11/2014 ndersa per vitn 2015 eshte ne proces. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të inventarizimeve rezulton se per vitin 2014 nuk është respektuar e plote procedura sipas udhëzimit nr 30 datë datë 27/02/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP”.

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Nga grupi i auditimit u krye inventar fizik me zgjedhje për një grup artikujsh sipas Akt konstatimit nr. 02 datë 17/03/2016. Nga krahasimi i gjendjes fizike dhe gjendjes kontable nuk rezultuan diferenca. Kushtet e mbajtjes së materialeve në magazinë janë optimale .

Nga ana e nëpunësit zbatues është hartuar regjistri analitik i aktiveve në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011“Menaxhimi i Aktiveve në NJSP”.Gjendja e aktiveve ne bilanc rakordon me gjendjen e aktiveve me 31/12/2014.

4.5 Organizimi, mbajtja e kontabilitetit dhe Pasqyrat Finaciare

Misioni i auditimit u ushtrua edhe në mbajtjen e kontabilitetit dhe të pasqyrave financiare për periudhen nen auditim.

U audituan transaksionet financiare të arkës në lekë, të veprimeve me bankën, veprimeve me magazinën. Kontabilizimi i pagave, shpenzimeve, blerjeve, lëvizjeve të magazinës, të aktiveve nuk bëhej në ditar të rregullt .

Sistemi kontabel per vitin 2014 nuk eshte i plote pasi eshte mbajtur “ditari i bankes“ ne te cilin regjistrohen U.Shpenzimet dhe njekohesisht kryhet rregjistrimi i shpenzimeve duke prekur llogarite e klases se gjashte (*parimi i arketimit dhe pagesave*) dhe nuk jane mbajtur “ditari i shpenzimeve“, “ditari te ardhurave“, “ditari i magazines“, “ditari i arkës“, “ditari i veprimeve te ndryshme“, “libri i madh“ apo “centralizatori“.Te dhenat ne pasqyrat financiare jane jane nxjerre ekstra kontabel.

Per vitin 2015 veprimet kontable jane rregjistruar programi financiar ALPHA Web te instaluar ne fund te vitit 2014. Programi eshte vene ne eficence dhe pasqyrat financiare te vitit 2015 jane hartuar nepermjet te dhenave te perpunuara ne program.

Pasqyrat Finaciare

Nga auditimi konstatohet se hartimi i pasqyrave financiare per vitin 2014 eshte kryer formalisht sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” nenet 3 dhe 5 të tij, ndersa per vitin 2015 jane kryer plotesisht sipas përcaktimeve te ligjit te sipercituar.

Pasqyrat Finaciare në analizë, kanë inventarin kontabël të cdo llogarie sipas V.K.M Nr.248, datë 10.4.1998 “Për planin kontabël të institucioneve buxhetore” dhe Udhëzimeve përkatëse të Ministrisë Financave “Per mbylljen e vitit financiar dhe paraqitjen e raportit vjetor”.

Pasqyrat Finaciare shoqërohen me raportin vjetor të bilancit dhe anekset përkatës. Pasqyrat Finaciare jane hartuar dhe dorëzuar në Degën e Thesarit Tirane , në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë ekonomike dhe pranë Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Bilanci pasqyron shpenzimet, të ardhurat, aktivet dhe pasivet. Nga auditimi i të dhënave të llogarive në celje te vitit ushtrimor rezulton se vlera e tyre përputhet me gjendjen në mbyllje të vitit paraardhës Në aktiv janë paraqitur të gjitha aktivet e qëndrueshme. Amortizimi është llogaritur sipas normave të amortizimit mbështetur në Udhëzimin nr.26 datë 27.12.2007 “Për përgatitjen e raportimin e pasqyrave Finaciare Vjetore për Institucionet Qëndrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njesive që varen prej tyre. Kërkesat për debitor, pasqyrojnë detyrimin e buxhetit për pagat dhe shtesat e tjera , që paguhen në janar të vitit pasardhës.

Llogaritë vjetore janë paraqitur sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe në zbatim të V.K.M. nr.248 date 10.04.1998 “Për Miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe Njësive që varen prej tyre, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26 datë 27.12.2007 “Për përgatitjen e raportimin e pasqyrave Finaciare Vjetore për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njesive që varen prej tyre si dhe të

njësive të menaxhimit/ zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj – dhe formateve të Pasqyrave Financiare të miratuara “

Të dhënat në këto pasqyra janë të sakta dhe korrekte”

4.6. Sistemi i prokurimeve me vlera të larta dhe vlera të ulëta

Gjykata Administrative Apelit Tirane, bazuar në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshimet perkatese, VKM nr.1 date 10.01.2007, i ndryshuar dhe VKM nr.914, date 29.12.2014, ka hartuar dhe derguar Regjistrin e Parashikimit te Prokurimeve Publike per shpenzimet operative dhe investimet per vitet 2014 dhe 2015 ne ZABGJ-re: Perkatesisht me shkresat nr.42/2 Prot, date 11.02.2014 dhe nr.29 Prot. date 30.01.2015.

Gjithashtu eshte derguar Regjistri i Realizimit te Prokurimeve Publike per vitet 2014 dhe 2015, perkatesisht me shkresat nr.17 Prot. date 16.01.2015 dhe nr. 14 Prot. date 15.01.2016.

Nga ZABGJ-re eshte miratuar regjistri i parashikimeve te prokurimeve publike për vitin 2014 dhe 2015. Në rastet e ndryshimeve është bërë kërkesa e argumentuar për ndryshimin dhe pas miratimit janë kryer veprimet e duhura.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor jane respektuar afatet ligjore dhe nenligjore per hartimin dhe dergimin e Regjistrit te Realizimit te Prokurimeve Publike ne ZABGJ. Ndersa ne hartimin dhe dergimin e Regjistrit te Parashikimeve te Prokurimeve Publike ka pasur tejkallim te afateve ligjore dhe nenligjore ne fuqi, vonesa te cilat kane lidhje me miratimin dhe dergimin e buxhetit ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane nga ZABGJ.

Ne prokurimet e kryera nga Autoriteti Kontraktore nuk jane zbatuar plotesisht Urdherat e Ministrit te Financave nr.33, date 11.07.2013 dhe nr.57, date 12.06.2014 “Per gjurmet standarde te auditit per prokurimin me vlere te vogel dhe te larte”, si dhe Urdheri Nr.1 datë 15.02.2012, miratuar nga Bordi Drejtues i ZABGJ.

Autoriteti Kontraktore per cdo procedure prokurimi te zhvilluar, ka nxjerre Urdherin e Prokurimit ku dhe eshte ngritur njesia e prokurimit. Gjithashtu me Urdherin nr.24 Prot. date 21.01.2015 eshte ngarkuar Njesia e Prokurimit edhe per : Perllogaritjen e Fondit Limit te argumentuar dhe Hartimin e Specifikimeve Teknike. Me Urdherat nr.40 Prot. date 03.02.2014 dhe nr.20 Prot. date 19.01.2015 eshte krijuar/ngritur njesia e prokurimit me vlera te vogla, per te funksionuar gjate gjithë vitit kalendarik, perkatesisht per vitin 2014 dhe 2015.

Auditi rekomandon:

Ne perputhje me piken 1 dhe 2 te nenit 57 te VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Te ngrihet Njësia e Prokurimit, e cila te administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimeve. Sugjerohje qe ne rastet kur nuk ka specialist te fushes brenda institucionit per percaktimin e specifikimeve teknike dhe kerkesave per kualifikim, te aktivizohen struktura te specializuara jashte Autoritetit Kontraktore.

-Ne perputhje me piken 2, njësia e prokurimit është përgjegjëse për: - sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik; - përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti); - përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme; - hartimin e urdhrat të prokurimit; - përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme; - hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore; - administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti; - llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Per periudhen Janar 2014 deri me 31 Dhjetor 2015, u audituan 5(pese) procedura prokurimi me vlere te larte sipas tabelës te mëposhme:

Te dhënat ne leke

N r	Viti	Objekti i Prokurimit	Vlera ne leke e Prokuruar me TVSH	Vlera ne leke e fituesve me TVSH	Llojet e procedurave
1	2014	Ruajtje dhe sigurie objekti	1 200 000	1 074 288	“Kerkese per propozim”
2		Blerje boje tonera	1 731 399	1 710 829	“Kerkese per propozim”
3		Blerje dhe montim serveri	800 000	686 760	“Kerkese per propozim”
4		Blerje paisje elektronike	2 150 000	1 998 682	“Kerkese per propozim”
1	2015	Ruajtje dhe sigurie objekti	1 575 810	1 071 768	“Kerkese per propozim”
		TOTALI :	7 457 209	6 542 327	

Per vitin 2014 eshte perdorur procedura e prokurimit “Kerkese per propozim” per 4 tendera ne vleren 5 881 399 leke me TVSH.

Per vitin 2015 eshte perdorur procedura e prokurimit “Kerkese per propozim” per 1 tender ne vleren 1 575 810 leke me TVSH.

Nga AK per periudhen nen auditim jane zhvilluar gjithsej 5 tendera, nga keto 4 ne vitin 2014 dhe 1 ne vitin 2015, me vlere totale **7 457 209** leke me tvsh. Tenderat e zhvilluara ne vitin 2014 jane perkatesisht nje per kontrate sherbimi dhe 3 kontrata per blerje mallrash, ndersa per vitin 2015 nga AK eshte zhvilluar vetem nje procedure prokurimi per kontrate sherbimi.

Per tenderat e audituar, nga grupi i auditimit u konstatuan mangesi e shkelje procedurale te njejta si dhe disa mangesi te vecanta. Ne perfundim te auditimit dhe ballafaqimeve te bera gjendja paraqitet si me poshte:

- Mangesite e njejta per tenderat e audituar:

- 1- Mosrealizimi ne kohe te procedurave te tenderave si pasoje e mungeses se personelit dhe experiences. Nisur nga fakti qe jane punonjes te rinj dhe pa experience, nuk jane marre masa per trajnimin e tyre.
- 2- Nga autoriteti kontraktore nuk eshte vepruar ne perputhje me VKM nr.1, date 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet perkatese, Kreun V, pika 1, germa “a”, si dhe me nenin 56 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Per ndarjen e detyrave te zyrtareve/nenpunesve te perfshire ne hartimin e dokumentave te tenderit (njesise se prokurimit) dhe atyre te perfshire ne procesin e vleresimit dhe te perzgjedhjes se fituesit, KVO- se.
- 3- Jo ne te gjitha rastet eshte kryer monitorimi i cilesise se realizimit te kontratave te lidhura me operatorët ekonomik, konkretisht: *Per zbatimin e kontratave me operatorët ekonomik fitues te ruajtjes dhe sigurise te nderteses se gjykates. Nuk rezulton te kete dale urdheri i brendshem nga Titullari i autoritetit kontraktore per monitorimin e zbatimit te kontrates ne perputhje me nenin 77, pika 3 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

- Mangesite e vecanta sipas tenderave te audituar:

Perveç mangesive e shkeljeve te njejta te cilesuar me larte, grupi i auditimit konstatoi edhe mangesi si me poshte:

Per vitin 2014

- Ne dosjet e tenderave te audituar nuk gjendet urdheri per ngritjen e komisionit te argumentimit te fondit limit, per rrjedhoje nuk eshte bere llogaritja e fondit limit

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

- Nga autoriteti kontraktore nuk eshte vepruar ne perputhje me VKM nr.1, date 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet perkatese, Kreun V, pika 1, germa “a”, si dhe me nenin 56 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Per ndarjen e detyrave te zyrtareve/nenpunesve te perfshire ne hartimin e dokumentave te tenderit (njesise se prokurimit) dhe atyre te perfshire ne procesin e vleresimit dhe te perzgjedhjes se fituesit, KVO- se.
- Jo ne te gjitha rastet eshte kryer monitorimi i cilesise se realizimit te kontratave te lidhura me operatoret ekonomik, konkretisht: *Per zbatimin e kontratave me operatoret ekonomik fitues te ruajtjes dhe sigurise te nderteses se gjykates. Nuk rezulton te kete dale urdheri i brendshem nga Titullari i autoritetit kontraktore per monitorimin e zbatimit te kontrates ne perputhje me nenin 77, pika 3 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

1.Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt “Sherbimi i Ruajtjes me Roje Civile” per vitin 2014

Nga verifikimi i dokumentacionit ne dosjen perkatese per kete tender, rezultoi si me poshte :

- Ne dosje nuk administrohet dokumentacioni per te argumentuar fondin limit, ne perputhje me VKM nr.1, date 10.01.2007 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public”, i ndryshuar, Kreu II, pika 2/c, sipas te ciles “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, *përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit*, analizon koston e mallrave, **të shërbimeve** dhe punëve, që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërme dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse dhe, në çdo rast i dokumenton ato”.
- Ne proceduren e mesiperme KVO-ve ka kualifikuar 5 operatore ekonomik qe nuk kane permbushur kerkesat ligjore te kerkuara ne DST; Konkretisht operatoret ekonomik “ALES” sh.p.k, “S.S.X” sh.p.k, “ARBANA” sh.a, “Leksi Security” sh.p.k dhe “Jori” sh.p.k. Per kualifikimin e padrejte te ketyre operatoreve ekonomik prane AK eshte bere ankese nga “NAZERI 2000” sh.p.k. duke vijuar me teje ankesen edhe ne KPP. Ky i fundit me vendimin nr.146/2014 date 14.04.2014 ka vendosur te pranoje ankesen dhe te skualifikoje operatoret ekonomik te mesiperme. Bazuar ne vendimin e KPP, KVO-ja prane AK ka bere rivleresimin e ofertave dhe ka shpallur fitues operatorin ekonomik “NAZERI 2000” sh.p.k ne vleren 895 240 leke pa tvsh.
- Nga ana e AK nuk eshte nxjerre Urdheri i Brendshem per kryerjen e monitorimit te cilesise se realizimit te kontrates.
- Inventari i dosjes te tenderit nuk eshte nenshkruar rregullisht nga Arkivistja dhe K/Njesise te Prokurimit, ky veprim eshte kryer ne nje proces verbal formal te mbajtur ndermjet tyre dhe jo ne fleten e inventarit te dosjes.

1. Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt “Blerje boje tonera

Nga verifikimi i dokumentacionit ne dosjen perkatese per kete tender, rezultoi si me poshte:

- Ne dosje mungon formulari i sigurimit te kontrates te operatorit “Infosoft Office” sh.p.k., dokument i cili duhet te paraqitet perpara lidhjes se kontartes bashke me formularin e nenshkrimin te kontartes dhe dokumentat origjinale ose fotokopje te noterizuara.
- Tenderi me objekt “Blerje boje Tонера”, sipas Urdhër Prokurimi Nr.745 Prot. datë 08.09.2014 eshte hapur nje here si procedure prokurimi per tu zhvilluar ne daten 19.09.2014 dhe eshte anuluar nga AK bazuar ne vendimin e KPP-se nr.548/1 Prot. date 30.09.2014.
- Arsyja e anullimit ka qene ankese e bere nga “ALBPRINT” sh.p.k. prane AK me nr.1260, date 12.09.2014, duke e vijuar ankesen e saje ne KPP me nr.1331 Prot. date 19.09.2014. Ankesea e bere nga “ALBPRINT” sh.p.k. konsiston ne vendosjen nga AK te kritereve te vecanta per kualifikim ne kundershtrim me ligjin 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin Publik”. KPP me

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

vendimin nr.548/1 Prot. date 30.09.2014, ka pranuar ankesen dhe ka urdheruar AK per anulimin e Tenderit.

- Me argumentin(detyrimin) per mos pasqyrimin e ndryshimeve ligjore ne vendosjen e kriterëve te vecanta te kualifikimit, si kerkesen e VKM nr.379, date 11.06.2014, ne lidhje me detyrimet qe kane autoritetet kontraktore per te kerkuar nga operatoret ekonomik pjesmarres ne tender te nje verteteimi qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike.
- Megjithese KPP ka vendosur per pezullimin e procedures te prokurimit me vendimin nr. prot. 1575/1, date 19.09.2014, autoriteti kontraktore ka proceduar me tej me dorezimin e ofertave ne daten 19.09.2014 si dhe vleresimin e tyre ne daten 23.09.2014. Veprim i cili bie ndesh me ligjin 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik", i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktore duhet te respektoje afatet per shqyrtimin administrativ te ankeses se operatorit ekonomik. Kjo ne kundërshtim dhe me VKM nr.1, date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit public", i ndryshuar, Kreu VI, pika 1 (ç), ku citohet... "Komisioni, pas mbarimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit. Pas miratimit nga titullari, autoriteti kontraktor dërgon njoftimin e fituesit dhe fton operatorin e përzgjedhur ekonomik të nënshkruajë kontratën, në përputhje me nenin 58, të LPP-së".

3.Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt "Blerje dhe montim serveri

Nga verifikimi i dokumentacionit ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi si me poshte :

-Ne dosje nuk administrohet dokumentacioni per te argumentuar fondin limit, ne perputhje me VKM nr.1, date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit public", i ndryshuar, Kreu II, pika 2/c, sipas te ciles "Autoriteti kontraktor, në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërme dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse dhe, në çdo rast i dokumenton ato".

4.Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt "Blerje Pisje Elektronike", me lote

Nga verifikimi i dokumentacionit ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi si me poshte :

- Nuk ka urdher per ngritjen e komisionit te argumentimit te fondit limit. Fondi limit eshte llogaritur nga K/Degete te Buxhetit, jo ne perputhje me VKM nr.1, date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II, pika 2/c, sipas te ciles, "Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh: - çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe - çmimet e tregut; ose/dhe - çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe - çmimet ndërkombëtare, të botuara".
- Skualifikimi i operatorit ekonomik "BNT Elektroniks" sh.p.k nga KVO-ve eshte bere ne kundërshtim me nenet 1, 2.a 45 dhe 55 te ligjit 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik". Ankesa e bere nga "BNT Elektroniks" sh.p.k prane AK nuk eshte marre parasysh nga kjo e fundit, per kete arsye operatori ekonomik e ka vijuar ankesen ne KPP, kjo e fundit ka vendosur te pranoje kerkesen e operatori ekonomik "BNT Elektroniks" sh.p.k dhe ka urdheruar AK te pezulloje proceduren e prokurimit dhe te beje riklasifikimin e OE pjesmarres ne konkurim. Ne perfundim te ketyre veprimeve nga AK, eshte shpallur fitues operatorit ekonomik "BNT Elektroniks" per te dyja lotet.

Per vitin 2015

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

Ne regjistrin e parashikimeve te prokurimeve publike, Autoriteti Kontraktore “Gjykata Administrative e Apelit Tirane” per vitin 2015 ka parashikuar te zhvilloje 5 Tendera ne vlere te larte, me proceduren e prokurimit “Kerkese per Propozim”. Ne fakt nga AK eshte kryer vetem procedura e prokurimit “Kerkese per Propozim”, me objekt “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private”, 4 procedurat e tjera jane kryer nga ZABGJ(autoriteti qendrore) me delegim te AK.

Per ruajtjen me roje private te godines se Gjykates Administrative te Apelit Tirane, jashte orarit zyrtare te punes si dhe ne ditet e festave zyrtare dhe te pushimit *per vitin 2015* eshte planifikuar dhe miratuar fondi ne shumen 2 344 000 leke nga Buxheti i Shtetit, vlere e cila eshte prokuruar nga AK me tre procedura prokurimi: Konkretisht per plotesimin e nevojave te fillim vitit per periudhen 01.01.2015-31.01.2015(shtese kontrate 20%) ne vleren **185 284 leke**. Per periudhen 01.02.2015-20.07.2015 me proceduren “Me negociim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates” ne vleren **1 078 956 leke**. Per periudhen 21 Korrik - 31 Dhjetore 2015, me proceduren e prokurimit te planifikuar ne fillimi te vitit ne regjistrin e parashikimit te prokurimeve publike “Kerkese per Propozim”, ne vleren **1 071 768 leke**.

Nga prokurimi i fondit te miratuar per kete ze shpenzimi ne vleren 2 344 000 leke per vitin 2015, vlera totale e kontratave te lidhura nga autoriteti kontraktore eshte ne shumen **2 333 495(182 770+1 078 956+1 071 769)** leke. Me nje kursim ne vleren 10 506(2 344 000 - 2 333 495) leke. Shuma gjithsej e paguar per kete ze shpenzimi ne vleren **2 333 495 leke**, eshte e barabarte me vleren totale te kontratave te lidhura nga AK.

Kokretisht prokurimi i fondit te miratuar per kete ze shpenzimi ne vleren 2 344 000 leke per vitin 2015, paraqitet si me poshte:

Lidhja e e kontrates shtese, 20% te vleres te kontrates baze.

1. Sipas Urdherit te Prokurimit nr.946 Prot. date 12.12.2014 eshte zhvilluar procedura e prokurimit, “Me negociim pa shpallje paraprake te Njoftimit te Kontrates” me objekt “Sherbimin e ruajtjes me roje private te godines se Gjykates Administartive te Apelit Tirane”. Per shtesen e kontrates baze Nr.347 Prot. date 05.05.2014(**20% te kontrates**), per periudhen 01.01.2015 deri ne daten 31.01.2015, me fond limit 185 284 leke me tvsh. Negocimi eshte zhvilluar ne daten 30.12.2014. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “NAZERI 2000” sh.p.k ne vleren 182 769 leke, eshte konsideruar si oferte e sukseshme dhe eshte shpallur fituese nga KVO-ja. Me operatorin ekonomik “NAZERI 2000” eshte lidhur kontrata e sherbimit Nr.978 Prot, date 31.12.2014 **ne vleren 182 769 leke** me tvsh.

2. Procedura e prokurimit, “**Me negociim pa shpallje paraprake te Njoftimit te Kontrates**” me objekt “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private” te Gjykates Administartive te Apelit Tirane, Nga verifikimi i dokumentacionit ne dosjen perkatese per kete tender, rezultoi si me poshte : Nga autoriteti kontraktore megjithese eshte hapur procedura e prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private” te Gjykates Administartive te Apelit Tirane, sipas UP nr.25 Prot date 21.01.2015, shpallur ne sistemin elektronik ne daten 28.01.2015, zhvilluar ne daten 12.02.2015. Ne daten 30.01.2015 eshte nxjerre UP nr.31/1 Prot. date 30.01.2015 per zhvillimin e procedures te prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates”. Per fondin e mbetur 1.766 589 leke pa tvsh, shprehur ne vleren e fondit ditor prej 5 289 leke pa tvsh, per nje vend roje, duke filluar nga data 01.02.2015 deri ne daten e lidhjes se kontartes per proceduren “Kerkese per Propozim”, shpallur ne sitemin elektronik ne daten 28.01.2015.

Ne daten 30.01.2015 nga AK eshte nxjerre Urdher Prokurimi Nr.31/1 Prot. Datë 30.01.2015, per zhvillimin e procedures “Me negociim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontartes” me objekt “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private” te Gjykates Administartive te Apelit Tirane, po ne kete date eshte bere dhe njoftimi i tre OE per daten dhe oren e zhvillimit te negociimit. Procedure e cila eshte zhvilluar ne ditet e daljes te Urdherit te Prokurimit date 30.01.2015. Ne dosjen e tenderit mungon procesverbali i perzgjedhjes te operatoreve ekonomik qe jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. Nga tre operatoret ekonomik te ftuar per te marre pjese ne konkurim eshte

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

paraqitur vetem operatori ekonomik "NAZERI 2000" sh.p.k.(operatori ekonomik i cili vazhdon te kryej sherbimin).

Mungesa e konkuresces tregon se perzgjedhja e operatoreve ekonomik pjesmarres nga NJP, nuk eshte bere ne perputhje me nenin 36, pika 4 dhe 5 te VKM-se 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Operatoreve ekonomik te ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi nuk ju eshte lene koha e mjaftueshme per pregaditjen dhe dorezimin e ofertes perkatese prane AK.

3.Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt "Sherbimi i Ruajtjes me Roje Civile" ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane per vitin 2015,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne dosjen perkatese per kete tender, rezultoi si me poshte :

-Nga ana e AK nuk eshte nxjerre Urdheri i Brendshem per kryerjen e monitorimit te cilesise se realizimit te kontrates. Gje e cila bie ndesh me nenin 77, pika 3 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"..... "*Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....*".

Njesia e Prokurimit duhet te jete e kujdesshme ne vendosjen e kriterëve te vecanta te kualifikimit, ne perputhje me nenin 1 pika 2/c,c,d dhe piken 1 te nenit 46 te LPP. Ne menyre qe te eliminoje zgjatjen e panevojshme te procedures se prokurimit dhe mos coptimin e fondeve publike. Referuar procedures te mesiperme, publikimi i njoftimit te kontrates ne BNJP te APP-se per kete tender eshte bere ne daten 28.01.2015 dhe ka vazhduar me lidhjen e kontrates ne daten 20.07.2015, gati 7-muaj nga celja e procedures.

Auditi rekomandon :

- *Kryetari i Gjykeses ne cilesine e Kryetarit te Autoritetit Kontraktor te marri masa per trajnimin e punonjesve te angazhuar ne procedurat e prokurimeve publike ne zbatim te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 83, pika 2.*

- *Te behet ndarja e detyrave te zyrtareve/nenpunesve te perfshire ne hartimin e dokumentave te tenderit (njesise se prokurimit) dhe atyre te perfshire ne procesin e vleresimit dhe te perzgjedhjes se fituesit, komisionit te vleresimit te ofertave ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te VKM-ve nr.914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Auditimi për prokurimet me vlera te vogla.

Mbeshtetur ne piken 5 te nenit 29, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

Ne piken 2/a "Prokurimi me vlere te vogel", te kreut VI "Zhvillimi i procedures se kerkeses per propozim, prokurimit me vlere te vogel, sherbimet e kosulences, konkursi i projektimit" te V.K.M-se nr.1, date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar. Me Urdherin nr.41 Prot. date 03.02.2014 nga AK eshte krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlera te Vogla per vitin 2014. Po keshtu bazuar ne nenin 40, pika 2, Kreu IV te V.K.M nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me Urdherin nr.21 date 19.01.2015 nga AK eshte krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlera te Vogla per vitin 2015.

Gjithashtu nga AK me urdherat nr.40 Prot. date 03.02.2014 dhe nr.20 Prot. date 19.01.2015 eshte krijuar Njesia e Prokurimit me Vlera te Vogla per vitet 2014 dhe 2015, veprim i cili nuk eshte i nevojshem te kryhet nga AK pasi nuk eshte i parashikuar ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni është hartuar e zbatuar sipas dokumentave standarte të APP-s. Procedurat për blerjet me vlera të vogla janë realizuar nëpërmjet sistemit elektronik dhe ne

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

rruge shkresore pas shpalljes dy here radhazi ne sistemin elektronik te prokurimit dhe anuluar per shkak te mungeses se konkurences.

Për vitet 2014 dhe 2015 per blerjet me vlera te vogla nuk jane zbatuar plotesisht kerkesat e Urdherave te Ministrit te Financave, nr.33, date 11.07.2013 dhe nr.57, date 12.06.2014 "Per gjurmet standarde te auditit per prokurimin me vlere te vogel dhe te larte" si dhe Urdheri Nr.1 datë 15.02.2012, miratuar nga Bordi Drejtues i ZABGJ.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit perkates rezulton se eshte vepruar ne përputhje me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", me ndryshimet perkatese, me VKM nr.1, date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar dhe me VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Te gjitha prokurimet me vlera te vogla rezultojne me dokumentacion shoqerues standart te parashikuar ne aktet ligjore dhe nenligjore te lartepemendur. Ne zhvillimin e procedurave te prokurimit per blerjet me vlera te vogla ne sistemin elektronik ne disa raste evidentohet si e mete mos perfundimi i fazes "Arkivim i Kontartes".

Auditi rekomandon:

- ***Kerkesat per pune, mallra apo sherbime duhet te jene me te qarta dhe te kene nje pershkrim me te hollesishem te punes, mallit apo sherbimit qe kerkohet te realizohet.***

V.Sistemi Informatik

Sistemi informatik eshte ne gjemdje te mire pune .

VI.OBSERVACIONE

Observacioni i paraqitur me shkresen nr. 463 Prot. date 09.05.2016 u vleresua me pergjegjesi per tematiken e trajtuar ne lidhje me pagesen e perkthyeses se gjuhes Turke dhe nuk merret ne konsiderate pasi nuk ka argumentim ligjor pervec atij te trajtuar ne fq.10-11 te ketij raporti.

VI. KONKLUZIONE REKOMANDIME DHE PIAN VEPRIMI I GJYKATËS

Duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit të gjykatës tuaj, NJAB- arrin në konkluzion që:

Gjykata Administrative e Apelit Tirane, paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e fondeve buxhetore, burimeve njerëzore dhe shërbimeve gjyqësore.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra, bazuar në nenin 6, pika c të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" për arritjen e objektivave në vitin 2016; kërkohet dhënien e rekomandimeve për ndreqjen e parregullsive, si dhe masat konkrete të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen në këtë subjekt auditues sipas sistemeve vijon:

1.Sistemi organizativ.

1. Te perfundoje hartimi dhe miratimi i Rregullores te Brendeshme, ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar, ku ndarja e detyrave, pershkrimet e punes dhe pergjegjesite te jene te qarta dhe sipas struktures aktuale per cdo punonjes qe ka funksione per menaxhimin e fondeve buxhetore, mbrojtjen e aseteve publike nga abuzimet, perdorimin e tyre me efektivitet, eficence dhe ekonomi.

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

2. Nga ana e gjykates te hartohet dhe te dergohet prane KLD-se, Ministrise se Drejtesise dhe ZABGJ-re, nje raport mbi nevojat per burime njerezore te argumentuar ne baze te ngarkeses individuale, bazuar ne nje detajim te plote te detyrave te gjithesecilit duke evidentuar problemet qe hasen gjate administrimit te punes ne Institucion. Ky raport gjykojme se do te sherbeje si nje nxitje pozitive per te adresuar problematikat e evidentuara te mungeses te kapaciteteve njerezore ne perballimin e funksioneve kryesore te gjykates.
3. Ne kuader te transparences te merren masa per vendosjen e kutise se ankesave te qytetareve si dhe te percaktohet procedura per shqyrtimin dhe evidentimin e tyre.
4. Dosjet e punonjesve te plotesohen sipas standartit te kerkuar per regjistrin kombetar te punonjesve publike, bazuar ne VKM-ne Nr. 117 date 05.03.2014 "Per Permbajtjen, Proceduren dhe administrimin e Dosjeve te personelit.....". *Regjistri themeltare* i punonjesve dhe Librezat e Punes te mbahen dhe azhurnohen nga Kancelari sipas kerkesave ligjore te marrdhenieve te punes. Per gjyqtaret krahas dosjes qe kane ne KLD, te krijohet dosje e ngjashme edhe ne Gjykate, ne kuader te vleresimit profesional si dhe per efektet financiare korrekte per vjetersit e pagueshme.
5. Për rekrutimet e reja ne administrate, te ngrihet komisioni ad hoc, i cili te hartojë kriteret e vecanta të e të përgjithshme konkurimit, te realizoje proceduren, te dokumentoje ate duke e arshivuar si dhe te lidhen kontratat e punes me punëmarrësin ne perputhje me "Kodin e Punes".
6. Pagesa e vjetersise ne sherbim te gjyqtareve te llogaritet mbi bazen e te dhenave zyrtare te KLD-se. Per keto vjetersi gjykata te disponoje dokument nga KLD, e cila mban regjistrin kombetare te gjyqtareve. Akti administrativ te dale nga Titullari Institucionit pasi te merren ne rruge zyrtare te dhenat per vjetersine e pagueshme per cdo Gjyqtare nga KLD.

I përkasin: Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit, K.D.Buxhetit

Niveli i prioritetit: Deri me 30.06.2016

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

7. Te hartohen Objektivat Strategjike te Institucionit, Deklarata per Cilesin e Sistemit te Kontrollit te Brendshem te plotesohet ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr.10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, dhe Manualin e MFK-se , miratuar me urdher te Ministrit te Financave me nr.8980 prot, date 15.07.2010 dhe te dergohen ne ZABGJ.
8. Në bashkepunim me Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqesor të planifikohen dhe realizohen *trajtime* të stafit të Gjykatës, në drejtim të legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, menaxhimin e burimeve njerezore, prokurimeve te fondeve publike dhe ne drejtime te tjera specifike.

I përkasin : Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit, K/Deges te Buxhetit

Niveli i prioritetit: Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

2.Sistemin e planifikimit dhe zbatimit te Buxhetit.

1. PBA te paraprihet me një program masash për hartimin e buxhetit ku të përcaktohen afatet edhe personat që do marrin pjesë në këtë proces. Te ngrihet grupi i punes per te paraprire per hartimin

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

e PBA grupi i punes per te paraprire per hartimin e PBA e sipas kerkesave te ligjit 10296 date 08.07.2010 ''Per menazhimin Financiar dhe kontrollin.

2. Te argumentohen sakte kerkesat buxhetore ,per cdo ze shpenzimesh. Gjithashtu te shoqerohej me dokumentin baze Deklarata e Politikes se Programit ,ku percaktohen qarte objektivat ne funksion te mbeshtetjes buxhetore .

I përkasin : Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit, K/Deges te Buxhetit

Niveli i prioritetit: Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

3.Sistemi Pagave dhe Pagesave.

1. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, të nxirret akti administrativ, të kryhet kontabilizimi dhe të bëhet ndalesa për pagese e kryer ne menyre te padrejte për perkthyesen ne vleren 9 900 lek.

I përket : Kryetarit, KDBuxhetit

Niveli i prioritetit: menjehere

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

4.Sistemi i prokurimit , blerjeve të vogla dhe zbatim kontratash

1. Ne perputhje me piken 1 dhe 2 te nenit 57 te VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ngrihet Njësia e Prokurimit, e cila te administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimeve. Delegimi i procesit te prokurimit te kryhet vetem ne raste e mallrave ose sherbimeve homogjene ne perputhje me nenin 2 te VKM se mesiperme. Ne rastet kur nuk ka specialist te fushes brenda institucionit per percaktimin e specifikimeve teknike dhe kerkesave per kualifikim, te punesoje me kontrate eksperte te jashtem (VKM 914 dt.29.12.2014,neni 1, paragrafi i fundit).
2. Te behet ndarja e detyrave te zyrtareve/nenpunesve te perfshire ne hartimin e dokumentave te tenderit (njesise se prokurimit) dhe atyre te perfshire ne procesin e vleresimit dhe te perzgjedhjes se fituesit(komisionit te vleresimit te ofertave) ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te VKM-ve nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
3. Autoriteti Kontraktor të marrë masa për mbikqyrjen e cilësisë së realizimit të kontratave te sherbimeve veçanërisht të ruajtjes dhe sigurisë fizikese te godinës se gjykatës në përputhje me nenin 77 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
4. Materialet dhe paisjet që vleresohen edhe nga karakteristikat e tyre te percaktuara ne specifikimet teknike te merren ne dorëzim nga komisioni me akt kolaudimi/akt marrje ne dorezim per mallrat duke saktësuar karakteristikat e produkteve sipas kontratës me ato të furnizuara në fakt nga

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE

furnitori, ne perputhje me kërkesat e udhezimit nr.30 date 27.02.2011 “Menaxhimi i Aktiveve ne NJSHP”.

I përkasin: Kryetarit, Njesise te Prokurimit, KVO-se, Komisioneve te marrjes ne dorezim.

Niveli i prioritetit: Në vijimësi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

5. Autoriteti Kontarktove te mos vazhdoje me proceduren e prokurimit pa u hequr pezullimi nga KPP, kjo ne perputhje me nenin 63 dhe 64 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
6. Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re prokurimi, te analizoje shkaqet, që ka shkaktuar dështimin e procedurës, dhe ti korigjojte ato në mënyrë, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës ne procedurat e prokurimit qe do te zhvillohen ne vazhdim.
7. Njesia e Prokurimit te tregojte me shume kujdes ne vendosjen e kriterëve te vecanta te kualifikimit, kerkesat te jene ne perputhje me nenin 1 pika 2/c,c,d dhe piken 1 te nenit 46 te LPP. Ne menyre qe te eliminohen zgjatjet e panevojshme te procedurave te prokurimit, mos coptimi i fondeve publike, sigurimi i konkurrences dhe barazia ne tendera.
8. Autoritetit Kontraktor te marri masa per trajnimin e punonjesve te angazhuar ne procedurat e prokurimeve publike ne zbatim te VKM nr.914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 83, pika 2.

I përkasin: Kryetarit, Njesise te Prokurimit, KVO-se

Niveli i prioritetit: Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

9. Arkivimi i dosjeve te tenderave, te kryhet ne perputhje me afatet e parashikuara ne Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, me ndryshimet perkatese, VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ne perputhje me ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003 “Per arkivat”.

I përket : Njesisë te Prokurimit dhe Arkivistes

Niveli i prioritetit: Në vijimesi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

10. Ne procedurat e prokurimit me vlera te vogla te zbatohet Urdheri i Ministrut te Financave nr.57, date 12.06.2014 “Per gjurmet standarte te auditimit per prokurimet me vlera te vogla dhe te larta, si dhe Urdheri Nr.1 datë 15.02.2012, miratuar nga Bordi Drejtues i ZABGJ.

11. Kerkesat per pune, mallra apo sherbime duhet te jene me te qarta dhe te kene nje pershkrim me te hollesishem te punes, mallit apo sherbimit qe kerkohet te realizohet.

I përkasin : Kancelarit, K/Deges te Buxhetit, K/Blerjeve te Vogla

Niveli i prioritetit: Në vijimesi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

5.Sistemi raportimit publik

1. Nga ana e kryetarit te meren masa per percaktimin e normatives se konsumit te karburantit per autoveturen nepermjet ngritjes me urdher te brendshem te komisionit per percaktimin e normativaves me matje faktike.

I përket : Kryetarit

Niveli i prioritetit: deri 30/06/2016

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

2. Per vleren e projektit ne shumen 6 180 000 lek te te llogaritet amortizimi vjetor me normen 15% per vitin 2015 e ne vazhdim deri ne perfundim te rikostruksionit te godines.

I përket : K.D. Buxhetit

Niveli i prioritetit: deri 30/06/2016

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

3. Nga dega e buxhetit te merren masa për mbajtjen e ditarit te arkës dhe librit te arkes, kryerjen e regjistrimeve kontabile për veprimet me arken , inventarizimin e vlerave monetare dhe te letrave me vlere cdo muaj, si dhe depozitim ne llogarite e thesarit te vlerave monetare të arkëtuara menjehere pas pranimi te tyre.

I përket : K.D. Buxhetit

Niveli i prioritetit: menjehere

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

6.Sistemi IT

1. Ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr.9887, date 10.03.2008, te ndryshuar mbi “Mbrojtjen e te dhenave personale”, Udhezimin Nr.15, date 23.12.2011 per “Perpunimin dhe publikimin e te dhenave personale ne sistemin gjyqesor”, Vendimin Nr. 1, date 04.03.2010 per “Percaktimin e rregullave te hollesishme per sigurimin e te dhenave personale”, si dhe akteve te tjera te Agjensise Kombetare te Shoqerise se Informacionit, te hartohet e miratohet Rregullorja specifike per IT.

I përket : Kryetarit të Gjykatës

Niveli i prioritetit : Deri me 30.06.2016

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

RAPORT FINAL
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANE


Këto rekomandime pasi të vlerësohen nga ju, do të shërbejnë si bazë për hartimin e plan veprimit dhe reagimit, me qëllim përmirësimin e punës, duke nxjerrë aktet përkatës dhe personat përgjegjës që do t'i zbatojnë ato gjatë vitit 2016 e në vazhdim.

Raporti Final hartohet ne dy kopje

GRUPI I PUNËS


Inspektor Audit Përgjegjës Grupi

Aristotel Telhaj



Inspektor Audit

Agim Koçi



Inspektor Audit

Trendafil Ajazi

